20	259/8	ARE+T	PRIVAT	SKENDER OSMAN SITA	1192	300	40	1192.69	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	134424.4	116400	116000	45600	412424.4
21	261/1	ARE+T	PRIVAT	BARI MYSLIM DULELLARI	2103	300	56	2103.37	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	271712.1	116400	235200	64500	687812.1
22	261/2	ARE+T	PRIVAT	PETRIT MYSLIM DULELLARI	2575	300	104	2574.56	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	342842.5	116400	270400	89000	818642.5
23	261/3	ARE+T	PRIVAT	NEZIR TEFIK DULELLARI	1767	300	86	1766.55	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	221076.9	116400	335400	84000	756876.9
24	261/6	TRUAL	PRIVAT	NEXH-BEDIN AMELI DULELLARI	300	300	76	348.06	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	116400	372400	3900	492700
25	261/7	ARE+T	PRIVAT	AMELI MYSLIM DULELLARI	5585	300	73	5537.03	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	796449.5	116400	357700	217750	1488299.5
26	262/3	ARE+T	PRIVAT	RRAPQ SHABAN DULELLARI	1229	300	61	1228.85	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	140000.3	116400	158600	159940	574940.3
27	263/1	ARE+T	PRIVAT	MAMUQJE ALI DULELLARI	1320	300	57	1320.59	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	153714	116400	131100	51800	453014
28	263/2	ARE+T	PRIVAT	RUSTEM KOCI DULELLARI	2362	300	67	2362.13	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	310743.4	116400	221100	96100	744343.4
29	267/5	ARE+T	PRIVAT	ISUF SHEME SHALCA	1732	300	68	1732.27	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	215802.4	116400	176800	0	509002.4
30	267/7	ARE+T	PRIVAT	SHYQYRI SHEME SHALCA	1859	300	75	1859.2	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	234941.3	116400	195000	37200	583541.3
31	267/9	ARE+T	PRIVAT	CELNIK MYSLIM DULELLARI	1554	300	98	1554.28	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	188977.8	116400	294000	31500	630877.8
32	282/6	TRUAL	PRIVAT	SERVET BAJRAM SORRA	600	600	70	304.53	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	232800	0	31500	264300
33	282/7	ARE+T	PRIVAT	FERIT NAZIF BAJRAMASI	2960	300	109	2960.41	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	400862	116400	0	0	517262
34	282/8	ARE+T	PRIVAT	AZIS NAZIF BAJRAMASI	1725	300	124	1725.26	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	214747.5	116400	0	0	331147.5
35	282/9	ARE+T	PRIVAT	BATO NAZIF BAJRAMASI	1053	300	117	1053.5	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	113477.1	116400	0	31500	261377.1
36	288/3	TRUAL	PRIVAT	ISA ZYFER SORRA	300	300	90	300.54	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	116400	189000	27600	333000
37	618/1	ARE+T	PRIVAT	SEFER HASAN CACI	429	300	66	428.69	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	19440.3	116400	79200	5800	220840.3
38	618/10	ARE+T	PRIVAT	VEIS ISMAIL CACI	1183	300	89	1183.4	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	133068.1	116400	106800	84700	440968.1
39	618/12	ARE+T	PRIVAT	SKENDER SEFER CACI	752	300	69	752.87	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	68116.4	116400	82800	0	267316.4
40	618/19	ARE+T	PRIVAT	VESEL GARIP QELASI	594	300	138	594.32	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	44305.8	116400	579600	0	740305.8
41	618/2	TRUAL	SHETI	SHETI	180	180	180	180.24	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	69840	594000	0	663840
42	618/20	ARE+T	PRIVAT	ASTRIT NURI QELASI	845	300	82	844.67	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	82131.5	116400	213200	0	411731.5
43	618/21	TRUAL	PRIVAT	RAMIZ GARIP QELASI	300	300	95	304.52	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	116400	465500	72200	654100
44	618/22	ARE+T	PRIVAT	ASQERI NURI QELASI	503	300	81	503.78	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	30592.1	116400	210600	44400	401992.1
45	618/5	TRUAL	SHETI	SHETI	70	70	70	69.22	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	27160	127500	0	154660
46	618/6	TRUAL	SHETI	SHETI	134	134	134	133.91	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	51992	227800	0	279792
47	618/7	TRUAL	PRIVAT	AQIF ASIM CACI	223	223	32	222.81	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	86524	92800	0	179324
48	618/8	TRUAL	PRIVAT	AGRON ASIM CACI	260	260	97	258.95	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	100880	630500	12300	743680
49	618/9	TRUAL	SHETI	SHETI	128	128	40	128.1	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	49664	420000	12500	482164
50	619	ARE+T	PRIVAT	BESIM NURI SORRA	1090	300	98	1090.03	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	119053	116400	254800	62800	553053
51	621/2	TRUAL	SHETI	SHETI	3344	3344	423	3343.67	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	1297472	1099800	25000	2422272
52	621/3	ARE+T	PRIVAT	RAHMAN RUSHAN SHALCA	1056	300	68	1055.81	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	113929.2	116400	176800	69000	476129.2
53	621/4	ARE+T	PRIVAT	SALI LAVER HOXHA	1003	300	105	1003.03	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	105942.1	116400	178500	51500	452342.1
54	622/1	ARE+T	PRIVAT	TRENDALIF LAVER HOXHA	743	300	95	643.37	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	66760.1	116400	313500	46900	542560.1
55	622/2	ARE+T	PRIVAT	MAZLEM LAVER HOXHA	1075	300	142	1075.53	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	116797.5	116400	923000	67000	1223197.5
56	622/3	ARE+T	PRIVAT	SHYQYRI RUSHAN HOXHA	1026	300	97	1027.88	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	109709.6	116400	174600	66000	466709.6
57	622/5	ARE+T	PRIVAT	ZENEL RUSHAN HOXHA	2458	300	107	2457.55	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	325210.6	116400	353100	0	794710.6
58	622/6	ARE+T	PRIVAT	PERPARIM ISA SORRA	1094	300	124	1093.73	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	119655.8	116400	223200	31200	490455.8
59	622/7	TRUAL	PRIVAT	SAZAN XHEMIL KACELLARI	300	300	107	1497.83	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	116400	449400	24750	590550
60	623/2	TRUAL	SHETI	SHETI	20	20	20	20.15	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	7760	325000	0	332760
61	623/4	TRUAL	SHETI	SHETI	44	44	44	44.5	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	17072	275000	0	292072
62	623/5	TRUAL	SHETI	SHETI	116	116	116	116.84	2520	Lumaj	Moglice	KORCE	tot.	0	45008	765600	0	810608
1	454/12	TRUAL	PRIVAT	MUHAMER MECAN XHEMOLLARI	300	300	57	268.87	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	116400	621300	71400	809100
2	454/9	ARE+T	PRIVAT	ALIM HODO XHEMOLLARI	2615	300	41	2614.58	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	985.74	117204.486	528900	0	646104.486
3	456/1	ARE+T	PRIVAT	FAHRI NAZMI XHEMOLLARI	2460	300	76	2460.09	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	256874	116400	828400	38000	1239624
4	456/2	ARE+T	PRIVAT	HYMER NAZMI XHEMOLLARI	1216	300	51	1215.78	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	108912.4	116400	555900	20000	801212.4
5	456/3	TRUAL	PRIVAT	KAJMAK NAZMI XHEMOLLARI	300	300	44	691.19	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	116400	479600	5975	601975
6	456/4	ARE+T	PRIVAT	SAFET NAZMI XHEMOLLARI	1676	300	264	483.87	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	163606.4	116400	2587200	21650	2888856.4
7	458/3	TRUAL	PA INFO	PA INFO	0	0	0	270.5	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	0	4382100	0	4382100
8	461/1	TRUAL	SHETI	SHETI	60	60	60	66.14	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	23280	192000	0	215280
9	461/10	TRUAL	SHETI	SHETI	82	82	82	82.41	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	31816	295200	0	327016
10	461/2	TRUAL	SHETI	SHETI	39	39	39	39.44	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	15132	124800	0	139932
11	461/5	TRUAL	SHETI	SHETI	313	313	313	313.36	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	121444	813800	0	935244
12	461/6	TRUAL	SHETI	SHETI	219	219	219	218.57	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	84972	481800	0	566772
13	461/8	TRUAL	SHETI	SHETI	260	260	260	260	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	0	100880	286000	0	386880
14	462/2	ARE+T	PRIVAT	MYSLIM LUTFI BEQIRAJ	2301	300	63	2300.68	2799	Nikollare	Moglice	KORCE	tot.	237918.9	116400	699300	0	1053618.9
1	168/2	ARE	PRIVAT	ADIL QANI ASIMLLARI	1006.87	0	0	1006.87	2710	Moglice	Moglice	KORCE	tot.	1006.87	157977.903	0	0	157977.903

2	2/5	ARE	PRIVAT	ETHEM ALI HENA	2691	0	0	2937	Osoje	Moglice	KORCE	tot.	2691	427061.7	0	0	42500	469561.7
1	11/19	ARE	PRIVAT	ISLAM SHERIF KOCI	2100	0	0	1842	Gramsh	Gramsh	Gramsh	tot.	2100	1577100	0	0	0	1577100
2	11/18	ARE	PRIVAT	SHAIQIR SHERIF KOCI	2100	0	0	1843	Gramsh	Gramsh	Gramsh	tot.	2100	1577100	0	0	0	1577100
3	11/17	ARE	PRIVAT	ISMET SHERIF KOCI	2100	0	0	1844	Gramsh	Gramsh	Gramsh	tot.	2100	1577100	0	0	0	1577100

Shuma totale LEK 278146846.8



VENDIM
Nr. 658, datë 26.9.2012

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 13 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 2. Metodologjia për vlerësimin e pronave të paluajtshme është burimi i vetëm zyrtar për përllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme.
 3. Miratimi i vlerës së pronës për secilin qark do të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.
 4. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.
 5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1
METODOLOGJIA
PËR VLERËSIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i kësaj metodologjie është përcaktimi i metodave dhe i rregullave për përllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme.
2. Qëllimi i kësaj metodologjie është garantimi dhe zgjidhja e drejtë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme për efekt të kompensimit të pronave ose gjatë proceseve të vlerësimit të pasurive të paluajtshme në tërësi, duke siguruar respektimin e së drejtës së pronës.

Neni 2
Parimet

Institucionet përgjegjëse, që trajtojnë çështjet e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, sipas kësaj metodologjie udhëhiqen nga parimi:

- a) i mbrojtjes dhe i garantimit të të drejtave kushtetuese të pronësisë;
- b) i ushtrimit të së drejtës së shpronësimit të pronës kundrejt një shpërblimi të drejtë;
- c) i ligshmërisë;
- ç) respektimit të standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurive të paluajtshme duke u bazuar në çmimin e tregut, llojin e pasurisë dhe qëllimin e përdorimit të saj;
- d) i drejtësisë dhe i paanësisë;

- dh) i bashkëpunimit me persona juridikë dhe privatë;
- f) i barazisë dhe i proporcionalitetit;
- ë) i përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve;
- f) i transparencës.

Neni 3

Vlera e pronës

1. Me vlerë të pronës do të kuptojmë përlllogaritjen e vlerës së pasurisë së paluajtshme, bazuar në qarkullimin civil të sendeve, sipas çmimit të tregut, llojit të pasurisë dhe qëllimit të përdorimit të saj.

2. Përlllogaritja e vlerës së pronës bëhet sipas standardeve ndërkombëtare të vlerësimit të pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në aneksin 1/1 të kësaj metodologjie, ku: vlera e pronës (VP) = çmimi i kontratës së shitjes.

3. Çmimi i kontratave të shitjes nënkupton çmimin e tregut, sipas llojit të pasurisë dhe qëllimit të përdorimit të saj. Çmimi i tregut nxirret nga të dhënat zyrtare të kontratave të shitjes të regjistruara në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme.

Neni 4

Llojet e pasurisë

Grupimi i të dhënave sipas llojit të pasurisë bëhet sipas ndarjeve dhe nënndarjeve të mëposhtme:

1. Tokë, ku përfshihet:

a) tokë truall me këto nënndarje:

i) truall;

ii) shesh;

iii) kanal;

iv) rrugë;

v) truall turistik;

vi) truall industrial;

b) tokë bujqësore me këtë nënndarje:

i) arë;

ii) ullishtë;

iii) vresht;

iv) pemëtore;

v) toka të pafrytshme që janë pjesë e fondit të tokës bujqësore;

c) pyje, livadh dhe kullotë;

d) tokë pyjore;

e) tokë e pafrytshme.

2. Objekte ndërtimore, ku përfshihen:

a) apartament, me këtë nënndarje:

i) apartamente;

ii) garsoniere;

iii) ambient banimi.

b) ndërtesë, me këtë nënndarje:

i) garazh;

ii) bodrum;

iii) depo;

iv) godinë;

v) shtëpi private;

vi) rezidencë;

c) njësi tregtare me këtë nënndarje:

i) njësi;



- ii) magazinë;
- iii) cisternë;
- iv) zyra;
- v) dyqane.
- d) ndërtesë publike me këtë nënndarje:
 - i) kopshte;
 - ii) shkolla;
 - iii) çerdhe;
 - iv) institucione;
 - v) kinema;
 - vi) muze;
 - vii) stadium;
 - viii) parqe;
 - ix) stacione;
 - x) objekte kulturore.
- e) ndërtesë industriale, me këtë nënndarje:
 - i) diga;
 - ii) hidrocentrale;
 - iii) tec-e;
 - iv) uzina dhe fabrika;
 - v) miniera;
 - vi) porte;
 - vii) landfille;
 - viii) ura.

3. Çdo lloj pasurie tjetër që nuk është përmendur në grupet, ndarjet e nënndarjet, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, për efekt të llogaritjes së vlerës së pronës, do t'i referohet grupimit, sipas funksionit të njëjtë apo të përafërt të tyre apo vlerës sociale, ekonomike, të llojit të pasurisë.

4. Kur një pronë është bashkim i një kategorie të tokës me një kategori të objektit ndërtimor, për efekt të llogaritjes së vlerës së pronës, vlera e saj nxirret për njësi, si shumë e vlerave të objektit ndërtimor dhe të tokës mbi të cilën ai ngrihet.

Neni 5 Grupimi i të dhënave

1. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përditëson të dhënat mbi vlerën e kontratave të shitjes çdo muaj. Gjatë 3-mujorit të fundit të çdo viti, bën grupimin përfundimtar të të dhënave për kontratat e regjistruara për një periudhë 1-vjeçare (njëvjeçare), për të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme, sipas zonave kadastrale të çdo qarku.

2. Në datën 15 nëntor të çdo viti, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dërgon zyrtarisht pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të dhënat e përpunuara, në mënyrë të unifikuar, në vlerë të plotë, sipas këtij formati:

Nr.	ZVRPP	Data e kontratës	Vlera e shitjes (në lek)	Lloj i pasurisë	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja në m ²

Neni 6

Mënyra e përpunimit të të dhënave

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, përpunon të dhënat e dërguara zyrtarisht nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke i grupuar ato sipas zonave kadastrale, nënndarjes brenda zonës kadastrale apo bashkimeve të dy apo më shumë zonave kadastrale, për qëllim të përllogaritjes së vlerës së pasurive të paluajtshme, sipas llojit të pasurisë, ndarjes dhe nënndarjeve të saj dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë vijimin e procedurave për miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave.

2. Përpunimi i të dhënave bëhet duke kryer këto veprime:

a) nxjerrjes së çmimit minimal dhe çmimit maksimal të kontratave të shitjes, për çdo kategori prone, në atë zonë kadastrale;

b) përllogaritjes së çmimit mesatar të kontratave të shitjes, për atë kategori prone, në atë zonë kadastrale;

c) përjashtimit fillimisht të vlerave 5% më të ulëta dhe ato më të larta të kontratave të shitjes. Nëse pas këtij përjashtimi vlera e pasurisë së paluajtshme nuk mund të përllogaritet, vijohet duke përjashtuar vlerat 10 % më të ulëta dhe ato më të larta të kontratave të shitjes;

d) llogaritjet moda, për çdo kategori prone, në atë zonë kadastrale, sipas numrit të përgjithshëm të kontratave. Moda është vlera që përsëritet më tepër;

e) llogaritjet mesorja për m², sipas numrit të përgjithshëm të kontratave. Mesorja është vlera mesatare e të gjitha transaksioneve për një lloj prone, në një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim zonash kadastrale;

f) përllogaritjes përfundimtare të vlerës së pasurisë së paluajtshme.

3. Numri minimal i kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme për një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim të tyre, për secilën lloj prone, së bashku me ndarjet e nënndarjet përkatëse, është 3. Në këtë rast vlera e pronës do të jetë e barabartë me mesataren e çmimit të kontratave të shitjes.

4. Në rast se për një zonë kadastrale, nënndarje apo bashkim të tyre, mungojnë transaksionet për një ndarje apo nënndarje të llojit të pasurisë së paluajtshme, atëherë përcaktimi i vlerës për këto zona do të bëhet mbi bazën e metodës indirekte, duke i grupuar kontratat e shitjes në një nivel më të afërt, sipas kësaj radhe: komunë, bashki, rreth, për atë grup të llojit të pronës.

5. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave bën pasqyrimin e të dhënave, sipas këtij formati:

Q A R K U	R R E T H I	B A S H K I A / K O M U N A	L A G J A / F S H A T I	Z O N A K A D A S T R A L E (ZK)	N Ë N D A R J A (ZK)	B A S H K I M I (ZK)	NR. I K O N T R A T A V E	V L E R A M I N I M A L E	V L E R A M A K S I M A L E	V L E R A M E S A T A R E	H E Q 5 %	H E Q 10 %	M O D A	M E S O R J A	V L E R A E P A S U R I S Ë	



Neni 7 Metodat e punës

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, për kryerjen e analizave krahasimore të të dhënave të përpunuara, për paraqitjen grafike të tyre, si dhe çdo veprim tjetër që do të jetë i nevojshëm për përllogaritjen e vlerës së pronës, bazohet në standardet ndërkombëtare të vlerësimit të pasurive të paluajtshme dhe kontrollit të saktësisë së të dhënave, të përcaktuara në aneksin 1/1, bashkëlidhur kësaj metodologjie.

Neni 8 Krijimi i hartës së vlerës

1. Hartat që do të përdoren për përgatitjen e hartës së vlerës të pasurive të paluajtshme, janë hartat kadastrale zyrtare të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Harta e vlerës krijohet në këtë mënyrë:

- a) Përpunimi i të dhënave nga kontratat e shitjes, sipas kësaj metodologjie;
- b) Përllogaritja e vlerës së pronës, sipas kësaj metodologjie dhe aneksit 1/1, bashkëlidhur saj;
- c) Përpilimi i hartës së vlerës, sipas modeleve të parashikuara në aneksin 1/2, bashkëlidhur kësaj metodologjie.

Neni 9 Dispozitë transitorë

1. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie, dërgon pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të dhënat zyrtare mbi kontrata e shitjes, sipas formatit të përcaktuar në nenin 5.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie, përgatit të dhënat për vlerën e pronës, për çdo zonë kadastrale, sipas përcaktimeve të bëra në këtë metodologji, dhe i propozon Ministrin të Drejtësisë vijimin e procedurave për miratimin e tyre nga Këshilli i Ministrave.

ANEKSI 1/1 VLERËSIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME, SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE DHE VERIFIKIMI I SAKTËSISË SË REZULTATEVE

KREU I PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

1. Vlerësimi i pasurive të paluajtshme bëhet duke u bazuar në parimin se operimi aktiv dhe me efikasitet të lartë i njësisë së mbledhjes së të dhënave të çmimeve të tregut dhe sigurimit të numrit të mjaftueshëm të të dhënave për analiza, përbën bazën e vetme për të siguruar cilësi të lartë dhe saktësi të rezultateve të dhëna nga procesi i vlerësimit të pronave.

2. Për të vlerësuar saktësinë e të dhënave të përfituara përdoren metoda shtesë në vlerësimin e treguesve statistikorë, të tillë si:

- a) “nivele të vlerës”, ku përfshihet raporti i vlerave tipike në periudha të caktuara më të gjata;
- b) “unitet i vlerave për grupet e pasurive të paluajtshme”;
- c) “barazi horizontale” dhe “barazi vertikale”.

KREU II

VLERËSIMI I PASURISË SË PALUAJTSHME

II/A. Masat e niveleve të vlerave

1. Llogaritjet e niveleve të vlerave të pasurisë së paluajtshme bazohet në masat e tendencës qendrore, ku përfshihen:

- a) mediana;
- b) vlera mesatare; dhe
- c) vlera mesatare e ponderuar.

2. Mediana është element i mesëm i grupit të klasifikuar të të dhënave.

3. Vlera mesatare llogaritet, duke mbledhur të gjitha vlerat e grupit të të dhënave, pjesëtuar me numrin total të vlerave.

4. Vlera mesatare e ponderuar llogaritet duke zbatuar mbi çdo proporcion pjesën “peshë”.

5. Mediana nuk varet në raportet minimale dhe/ose maksimale, por mediana e krahasuar me dy masat e tjera, vlera mesatare dhe vlera mesatare e ponderuar, praktikisht nuk varet nga gabimet e të dhënave.

6. Mediana merret si bazë për llogaritjen e “koeficientit të shpërndarjes” (COD).

7. Koeficienti i shpërndarjes është masa kryesore e unifikimit të vlerës.

8. Papërsosmëria e vlerës mesatare të ponderuar ka të bëjë me ndjeshmërinë e saj në lidhje me gabimet e grupit të të dhënave, në rastet kur të dhënat e vendosura përmbajnë disa gabime, vlerat e pasurisë së paluajtshme japin ndryshim relativisht të madh në raport me çmimin e tregut.

9. Masat e tendencës qendrore përdoren njëkohësisht dhe krahasimi i të tria masave jep informacion shtesë në lidhje me shpërndarjen e përqindjes së vlerës. Dallimet e vogla midis vlerave të këtyre masave përbëjnë tregues për simetrinë e mirë të shpërndarjes së përqindjeve të vlerave.

II/B. Masa të unitetit të vlerës

1. Masa të unitetit të vlerës së pasurisë së paluajtshme janë:

- a) uniteti ndërmjet grupeve të pronësisë; dhe
- b) uniteti brenda grupeve të pronësisë.

2. Uniteti ndërmjet grupeve të pronësisë mund të analizohet duke bërë krahasimin e masave të llogaritura të nivelit të vlerës për secilin grup të veçantë të pasurisë.

3. Indekset që përdoren për krahasimin e të dhënave të vlerës së pasurisë së paluajtshme llogaritet nëpërmjet metodave statistikore, ku përfshihen:

- a) amplituda, kuartilet dhe përqindjet;
- b) koeficienti i shpërndarjes (COD);
- c) koeficienti i variacionit (KV).

4. Amplituda, kuartilet dhe përqindjet ofrojnë pika mbështetëse, të cilat karakterizojnë shpërndarjen në grupin e të dhënave. Amplituda është diferenca midis vlerës maksimale dhe minimale në grupin e të dhënave. Amplituda e madhe përbën tregues të unitetit të keq të grupit të të dhënave. Amplituda bazohet vetëm në vlerat maksimale dhe minimale dhe për këtë arsye përfundimi në lidhje me unitetin e grupit të të dhënave duhet të bëhet me përdorimin e treguesve shtesë.

5. Treguesit shtesë të përdorur së bashku me amplitudën dhe shmangien e paraqitjes së konkluzioneve të gabuara janë:

- a) përqindjet;
- b) kuartilet;
- c) amplitudat e interkuartileve; dhe
- d) koeficientet e përqendrimit.

Duke kombinuar së bashku të gjitha këto masa llogaritet saktësisht shkalla e unitetit të grupit të të dhënave.

6. Koeficienti i shpërndarjes (COD) është masa më e përdorur e unitetit të vlerës. COD bazohet në “devijimin mesatar” (VN), i cili llogaritet nga formula:



$$VN = \frac{1}{n} \sum \left| \frac{KV_i}{TV_i} - \overline{\frac{KV}{TV}} \right|$$

$\overline{KV/TV}$ - Mediana e proporcioneve kadastrale dhe të çmimeve të tregut;

KV_i/TV_i - Proporcioni i objektit ndërmjet vlerës kadastrale dhe çmimit të tregut;

n – Numri i proporcioneve.

7. Koeficienti i shpërndarjes (COD) shpjegon devijimin mesatar në përqindje. Koeficienti i shpërndarjes (COD) jep masën e unitetit të vlerës të pavarur nga niveli i vlerës dhe mundëson krahasimin ndërmjet grupeve të pronësisë.

8. Koeficienti i shpërndarjes (COD) llogaritet duke pjesëtuar devijimin absolut me medianën dhe duke e shumëzuar rezultatin me 100, me qëllim për të arritur shifrën përfundimtare në përqindje:

$$COD = \frac{VN}{\overline{KV/TV}} 100$$

9. Vlera e ulët e koeficientit të shpërndarjes (COD) (≤ 15.0) karakterizon unitet të mirë të vlerave. Vlera shumë të ulëta të COD-së prej < 5.0 janë shumë të rralla.

10. Koeficienti i variacionit (KV) është devijimi standard i shprehur në përqindje dhe llogaritet duke pjesëtuar devijimin standard me vlerën mesatare të proporcionit dhe duke e shumëzuar rezultatin me 100 për arritjen e dimensionit në përqindje, si më poshtë:

$$COV = \frac{s}{\overline{KV/TV}} 100$$

$\overline{KV/TV}$ - vlera mesatare e proporcionit kadastral dhe çmimit të tregut;

s – Devijimi standard.

11. Devijimi standard llogaritet me formulën e mëposhtme:

$$s = \sqrt{\frac{1}{n-1} \sum (KV_i/TV_i - \overline{KV/TV})^2}$$

12. KV-ja dhe COD-ja përdoren për krahasimin e grupeve të ndryshme të pronësive me nivele të ndryshme vlerash.

13. Interpretimi i KV-së bazohet në prezumimin e “shpërndarjes normale” të proporcioneve të vlerave të pasurisë së paluajtshme. Nëse shpërndarja nuk është “normale”, KV-ja nuk jep masa korrekte dhe të dhënat duhet të korrigjohen duke fshirë “gabimet e këqija” dhe duke arritur shpërndarjen normale. Kur shpërndarja e të dhënave është “normale”, atëherë për KV-në zbatohen:

- a) numri i ndryshimit të KV-së nga mesatarja është (+/-) 1; përqindja e të dhënave është 68%;
- b) numri i ndryshimit të KV-së nga mesatarja është (+/-) 2; përqindja e të dhënave është 95%;
- c) numri i ndryshimit të KV-së nga mesatarja është (+/-) 3; përqindja e të dhënave është 99%.

14. Secili prej grupeve më të mëdhenj të pronësisë duhet të përfshihet në kufirin e 5 për qind nga niveli i vlerës së përgjithshme në territorin e caktuar administrativ.

KREU III VERIFIKIMI I SAKTËSISË SË REZULTATEVE

1. Verifikimi i saktësisë së të dhënave, përveç përdorimit të metodave të parashikuara në kreun II të këtij standardi, bëhet edhe nëpërmjet përdorimit të diagramit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, ku përfshihet:

- a) histograma;
- b) diagramet kuti; dhe

c) ngastrat e shpërndara.

2. Histogrami është diagram i llojit kolonë i shpërndarjes së frekuencës së të dhënave për vlera të caktuara të numrave. Lartësia ose katrori i kolonave tregojnë numrin e ngjarjeve (vlerat, rastet, proporcionet) ose përqindjet. Kolona më e lartë tregon shkallën e vlerësimit më të shpeshtë; trashësia e shpërndarjes karakterizon unitetin e vlerave.

3. Histogrami tregon se si vlerat e mira përgjigjen ndaj “shpërndarjes normale”.

4. Të dhënat e situatës së tregut të të dhënave të pasurisë së paluajtshme në “kurbën e Gausit” përdoret si tregues i një tregu normal.

5. Pasqyrimi i të dhënave në histogram, bëhet sipas modelit të mëposhtëm:




Figura1. Vlera kadastrale dhe çmimi i tregut. Histogrami i proporcionit të vlerave në 1 milion banorë. [“Dev.St.” – devijimi standard; “do të thotë” – mesatare; “N” – numri i rasteve të analizuar, të dhënat për vitin 2011]

6. Shpërndarja e të dhënave me boshllëqe dhe/ose shpërndarja e të dhënave josimetrike në të majtë dhe në të djathtë të vijës së shpërndarjes “normale” është tregues i drejtpërdrejtë i të dhënave të pasakta stilistikisht, ku përfshihen shifrat artificiale, masat e gabuara, dhe gabimet e këqija.

7. Krijimi i histogramave dhe kurbave të “shpërndarjes normale” përdoret si model për shqyrtimin e besueshmërisë së të dhënave të marra për analizë.

8. Përdorimi praktik i kësaj metode të analizimit të të dhënave bëhet kur numri i ngjarjeve, proporcioneve dhe çmimeve të jetë:

a) më i madh se 100 (njëqind), për analizë paraprake dhe gjetjen e gabimeve të këqija; dhe

b) më i madh se 1000 (një mijë) për analiza të sakta dhe korrekte.

9. Diagrami kuti për shpërndarjen e të dhënave (*box plots*) përdoren për vizualizimin e vlerave. Kutitë reflektojnë amplitudën e interkuartileve, që është ndryshimi midis kuartiles së tretë dhe të parë. Brenda kutive, vijat horizontale me të zezë janë medianat.

10. Diagramet kuti janë mjet i mirë për njohjen e gabimeve të këqija, artificiale dhe rezultateve të rreme.

11. Qarqet dhe yjet që shfaqen jashtë kutive tregojnë gabimet potenciale të këqija ose “pikat e papërshtatshme”. Vlerësuesit duhet të analizojnë secilën prej këtyre “pikave të papërshtatshme”, dhe duhet të përcaktojnë dhe arsyen e caktuar.

12. Vendndodhja e medianave dhe kutive tregon barazi të mirë dhe unitet të mirë të vlerave ndërmjet territoreve administrative të zonës kadastrale.

13. Pasqyrimi i të dhënave në diagramin kuti bëhet sipas modelit të mëposhtëm:




Figura 2. Box plots

14. Ngastra është mjet efikas për krahasimin e proporcionit kadastral dhe çmimit të vlerës së tregut, me ndryshore sasiore, si hapësira e apartamentit, e sipërfaqes së tokës dhe vjetërsia e ndërtesës.

15. Proporcioni kadastral dhe i çmimit të tregut vendoset në boshtin vertikal dhe variabla aktuale vendoset në boshtin horizontal.

16. Shpërndarja e pikave tregon objektivitetin e vlerave në të gjithë fushën e variablës sasiore. Në rast të shfaqjes së zhvendosjes sistematike të pikave “lart” ose “poshtë”, vlerësuesi duhet të tërheqë vëmendje në lidhje me pabarazinë e të dhënave ose vlerat tendencioze.

17. Vija e kuqe horizontale është mediana. Vendndodhja e pikave nuk tregon ndonjë tendencë “lart” ose “poshtë” të pikave.

18. Pasqyrimi i të dhënave në ngastra, bëhet sipas modelit të mëposhtëm:




Figura 3. Ngastrat [40, 60, 80, 100 – metra katrorë të apartamentit]

ANEKSI 1/2

MËNYRA E PËRPILIMIT TË HARTAVE TË VLERËS SË PRONËS

Nga tabelat e të dhënave, ku pasqyrohen vlera të regjistruara në ZRPP, merret çmimi i shitjes, që është një tregues i vlerës së tregut (lek/për njësi), për çdo pasuri korresponduese. Më pas, kryhet pozicionimi i vlerave të kontratave të shitjeve në një territor të caktuar në hartë, HTR të ZRPP-së dhe heqja e vijës së vlerës, sipas përlllogaritjes së vlerës mesatare për njësi. Në rastin e apartamenteve, të cilët janë ndërtesa në një godinë të përbashkët, çmimi i shitjes përcakton çmimin e shitjes lek/m². Duke qenë se, për çdo kalim pronësie çmimi i kontratës së shitjes regjistrohet, atëherë vlerësimi i kësaj pasurie konsiderohet i regjistruar.

Për të pasqyruar mënyrën se si do të funksionojë metodologjia, figurat e mëposhtme paraqesin disa shembuj modele, ku pasqyrohet marrëdhënia ndërmjet izovlerës apo çmimit të llogaritur të shitjes për njësi dhe pasurive të një lloji të caktuar si p.sh.: ndërtesë, apartament, truall, pyll etj., te ndodhura në të njëjtën izozonë, duke krijuar harta vlere zone për pasuri të të njëjtit lloj, sipas të dhënave zyrtare të regjistruara në ZRPP. Zonat e vlerës apo izozonat, krijohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit sipas grupimit të të dhënave, grupim i përcaktuar në nenin 5 dhe 6 të metodologjisë, sipas përlllogaritjes së vlerës së pasurisë, duke krijuar harta të ndryshme vlere për çdo kategori pasurie, sipas një harte bazë.




Figura nr. 1. Shembull. Hartë vlere për sa i takon çmimit të apartamenteve, në një zonë kadastrale në Tiranë

Shënim. Çdo izovlerë, për një çmim mesatar të llogaritur, është individualizuar me një vizim sipas një ngjyrimi, si në figurën 1.




Figura nr. 2

Në figurën nr. 3 janë pasqyruar në një HTR të përbashkët izovlerat për të dy shembujt më sipër. Harta e krijuar jep përfytyrimin e hartës së vlerës, që në vijim do të krijohet për llojin e pasurive sipas nënndarjes përkatëse. Shembulli në vijim pasqyruar në figurën nr. 3, paraqet një izovlerë për llojin e pasurisë “pyll”, ku janë dhënë vlerat e çmimit minimal dhe maksimal. Izozona është ndërtuar për sa i takon çmimit të vlerës mesatare, Berat.




Figura nr. 3. Paraspuar, Berat




Figura nr. 4. Vokopolë, Berat



Berat.




Figura nr. 6. Izozonë me vlerë mesatare për çmim lek/m², tokë truall, Korçë




Figura nr. 7. Fragment, si do të paraqitet në total hartimi i hartës së vlerës për rastin e tokës, lloji “truall”, shembull – Korçë.

VENDIM
Nr. 659, datë 26.9.2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 803, DATË 21.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR GRADAT
NË POLICINË E SHTETIT DHE EKUVALENTIMIN E TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 39 e 126 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Tabela e ekuivalentimit dhe e funksioneve korresponduese për çdo gradë”, bashkëlidhur dhe përmendur në pikën 1 të vendimit nr. 803, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e Policisë së Shtetit, për vitin 2012.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhje nr. 1
TABELA E EKVIVALENTIMIT DHE E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË

Grada Ekuivalente	GRADA	FUNKSIONET	
		Drejtues i Parë	Drejtues i Përgjithshëm
Drejtues	Drejtues i Përgjithshëm		Drejtues i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
	Zëvendësdrejtues i Përgjithshëm		Zëvendësdrejtues i Përgjithshëm i Policisë.
Kryekomisar Komisar	Drejtues i Parë		Drejtues në DPPSH, drejtues në Departamentet e DPPSH, drejtues në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, Drejtues i FPO, drejtues i Policisë Rugore, drejtues i DPQ, drejtues i QFP, shef i asistent sekretariatit të Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtues i QPMMDH, drejtues i BKN, drejtues i Standardeve Profesionale, asistent i Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtues dhe shef sektori në DSSB dhe specialist koordinator në Drejtorinë e Analizës dhe Studimeve Strategjike.
Nënkomisar	Drejtues		Shef sektori në DPPSH, shef sektori në Departamentet e DPPSH, shef sektori në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, shef sektori në FPO, shef sektori në Drejtorinë e Policisë Rugore, shef sektori në QFP, shef sektori në QPMMDH, Shef Komisarati Special RENE, shef sektori në BKN, shef sektori në Drejtorinë e Standardeve Profesionale dhe DTL, zëvendësdrejtues në DPQ, drejtues i DRK&M, specialist në Seksionin e Menaxhimit të nivelit të mesëm e lartë drejtues në QFP si dhe specialist, asistent (sekretariat) pranë Zv/ drejt kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Renda, specialist, oficer kontakti, ndërlidhës në Drejtorinë BKN, specialist koordinator në Sektorin e Botimeve në DSSB.
Kryeinspektor	Kryekomisar		Specialist në DPPSH, specialist në Departamentet e DPPSH, specialist në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, shef qendre në FPO, specialist në FPO, specialist në Drejtorinë e Policisë Rugore, specialist QPMMDH, specialist BKN, Specialist në Drejtorinë e Standardeve Profesionale, Komandant i RSBC, shef sektori në DPQ, shef sektori në DRK&M, shef Komisarati Policie, shefi komisarati K&M, shef sektori në QFP, Shef Komisarati Special RESI dhe ndërhyrjes shpejtë, Shef Komisarati i Helikopterëve, shef i IPQP, specialist në seksionin e Menaxhimit të nivelit të parë drejtues në QFP, shef i strukturës autonome pranë DPPSH, shef i Njësisë Antieksplzivave, shef i Njësisë së Negociatorëve, Shef Qendre FPO.
Inspektor	Komisar		Shef seksioni në DPQ, shef seksioni në DRK&M, shef seksioni në DPQ, shef seksioni në DRK&M, shef seksioni në komisarate Policie, shef seksioni në komisaritet K&M, shef stacioni i K&M, shef seksioni në strukturat autonome në varësi të DPPSH, shef i planifikimit/koordinimit operacional në repartet speciale dhe ndërhyrjes shpejtë, shef i Fluturimeve, komandant Ekuipazhi, pilot, inxhinier e teknik AS-350, teknik bordi fluturues mi-8, teknik mi-8, specialist në QFP, shef seksioni në IPQP, shef seksioni në strukturat autonome DPPSH, Zv/Shef Njësie FPO.



Nëinspektor	Nënkomisarë	Specialist në DPO, specialist në DRK&M, shef Stacioni Policie, specialist në Komisarate e stacione Policie, specialist në komisarate e stacione Policie të K&M, specialist në strukturat autonome në varësi të DPPSh, komandant grupi në repartet speciale dhe ndërhijes së shpejtë, komandant grupi në RSBC, specialist në IPQP, specialist në strukturat autonome pranë DPPSh, përgjegjës turni në stacionet e Policisë K&M.
Kryeasistent Asistent i Parë Asistent	Kryeinspektor	Ndihmës specialist në strukturat e hetimit të krimeve, të policisë shkencore, të policisë së rendit, të sallave operative të drejtimit dhe koordinimit, ndihmës specialist (kontroll or) në Policinë K&M, në forcat speciale, përgjegjës grupi, komandant skuadre.
Agjent i Parë Agjent	Inspektor	Funksione të nivelit zbatues në strukturat administrative mbështetëse, trupë shërbimi në gjitha strukturat e policisë (përfshirë trupat në repartet speciale), në patrullat e përgjithshme të policisë, trupë shërbimi në forcat e ndërhijes së shpejtë.
	Nëinspektor	Punonjës policie në periudhën 2-vjeçare të provës.

Shpjeguese:

Shkurtime të përdorura në tabelën e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë:

DPPSh	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
FPO	Forcë e Posaçme Operacionale
QPMDH	Qendra e Përpunimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave
BKN	Bashkëpunimi dhe Koordinimi Ndërkombëtar
QFP	Qendra e Formimit Policor
DPQ	Drejtoria e Policisë në Qark
DRK&M	Drejtoria Rajonale e Kufirit & Migracionit
RSBC	Reparti Sigurisë së Brendshme dhe Ceremoniali
IPQP	Instituti Përgatitjes Qenve të Policisë
QFMT	Qendra e Furnizimit Materialo teknike (strukturë autonome pranë DPPSh)
QShAMT	Qendra e Shfrytëzimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit (strukturë autonome pranë DPPSh)
QPM	Qendra Profilaksisë dhe Mjekimit (strukturë autonome pranë DPPSh)
QShTI	Qendra Shërbimeve të Teknologjisë Informatike (strukturë autonome pranë DPPSh)
DSSB	Drejtoria e Studimeve Strategjike dhe Botimeve

VENDIM
Nr. 660, datë 26.9.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1135, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, bashkëlidhur dhe përmendur në pikën 1 të vendimit nr. 1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhja nr. 1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi													
Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Në funksione organike për hetimin e krimeve kundër krimt të organizuar. Oficerët e Policisë. Gjyqësorë. Specialistë të policisë në zonë. Në funksione organike të mbrojtjes së të mirave dhe dhunës në familje. Në funksione të drejtorisë së bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-kombëtar	Në funksione të Forcës së Posaçme & Oficerët të Policisë Gjyqësor e pranë Prokuror 1 së për Krimet e Rënda	Në funksione të sigurisë publike. Policia Rrugore. Qendra e Emergjencave e sallave operative. Ruajtja e siguria e objekteve	Në funksione ndalim paraburgim i	Në funksione organike të Policisë kufitare & migracioni t	Në funksione operuese të Forcave speciale (Shef Kom. Shef plan. kord. Op. në RENEA. Helikopterët, Njësia Antieksploziv. Njësia e Negociatorëve & Njësia e Lëvizshme Territoriale për Kufirin e Migracionin (Shef dhe Zv/shef Njësie)	Në funksione operuese ndërhyrjes së shpejtë ((Shef Komisariat, Shef Planifikimi dhe Kordinimi operacional)	Drejtor e Zv/drejt i Policisë së Qarkut. Shef komisarati. Shef stacioni. Komandant i Rep të Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit	Në funksione të drejtorisë së mbrojtjes së dëshmitarë ve dhe bashkëpunët orëve të drejtësisë. Komisarati Special RESI (Shef Kom, Shef Plan. Kord.) & Njësia operacionale Mbrojtjes së Dëshmitarë Ve	Në funksione të shërb mbështetë se & administratve në Policinë e Shtetit	Në funksione organike Drejtor & Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Drejtor i Policisë së Qarkut & Tirane & Drejtoria e Forcave të Lëvizshme Operacionale
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	
Niveli zbatues	Nëinspektor	37500	6500		5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
	Inspektor	41000	6500	16500	5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
Niveli i Pare	Kryeinspektor	46000	6500	17500	5500	6500	5500	40000	7000		30000	2000	
	Nëkomisar	55500	6500	18500	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	
	Komisar	62000	6500	19500	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	
Niveli i drejtues	Kryekomisar	84000	6500	22000	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
	Drejtues	95500	6500	20000	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
	Drejtues I	98500	6500	20000	5500		5500	40000	7000	6000	30000	2000	15000
Niveli i lartë	Zv/Drejtor i Përgjithshëm	109000											15000
	Drejtor i Përgjithshëm	118000											20000

VENDIM
Nr. 662, datë 26.9.2012

PËR HEQJEN E LICENCËS SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “UNIVERSITETI EUROPIAN I TURIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 44 pika 8, e 45, pika 4, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës shkollës së lartë private “Universiteti European i Turizmit”, si dhe të lejeve për hapjen e programeve të studimeve në zbatim të saj.
 2. Shkolla e lartë private “Universiteti European i Turizmit” të ofrojë mjetet e nevojshme financiare dhe mundësitë për përfundimin e studimeve të filluara për të gjithë studentët që janë të regjistruar në institucion, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
 3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë private “Universiteti European i Turizmit” për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 663, datë 26.9.2012

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË PRONËSI TË ALBTELECOM SHA, TË CILAT PREKEN NGA MASTERPLANI I MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 546, DATË 28.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MASTERPLANIT PËR ZHVILLIMIN E PORTIT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga masterplani i miratuar me vendimin nr. 546, datë 28.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit”.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Portual Durrës.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe trualli 3 289 (tri mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) m², vlerësuar me çmimin 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme 98 670 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë; objekte me vlerë 15 340 387 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e dyzet mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 114 010 387 (njëqind e katërmëdhjetë milionë e dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 435 000 (katërqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë, do të përballohen nga Autoriteti Portual Durrës.
5. Vlëra e përgjithshme e shpronësimit prej 114 010 387 (njëqind e katërmëdhjetë milionë e dhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekësh, do të përballohet nga Autoriteti Portual Durrës.



6. Shpronësimi të fillojë më 1.10.2012.
7. “Albtelecom” sh.a. do të kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë dorëzuar, pranë Autoritetit Portual Durrës, dokumentacionin e plotë të pronësisë.
8. Autoriteti Portual Durrës do të likujdojë “Albtelecom” sh.a., sipas pikës 7 të këtij vendimi.
9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Portual Durrës, të fillojnë procedurat për kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Portual Durrës.
10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur do të realizohet kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.
11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Autoriteti Portual Durrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AUTORITETI PORTUAL DURRES

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN SI REZULTAT I NDERTIMIT TE
"HYRJES NR.4 TE RE, SEGMENTIT RRUGOR NGA HYRJA NR.4 TEK TERMINALI I RI I TRAGETEVE
DHE REHABILITIMIN E SHESHIT PRANE HYRJES NR.4 NE PORTIN E DURESIT"

Nr	PRONARI			Z.K	Pas.	TRUALL M2			OBJEKTE	VLERA	Shenime
	Emri	Atesi	Mbiemri			M2	Cmimi	Vlera ne leke	VLERA LEKE	TOTALE LEKE	
1	"ALBTELECOM" sh.a			8514	6/111	3289	30000	98,670,000	15,340,387	114,010,387	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI					3289		98,670,000	15340387	114,010,387	

VENDIM

Nr. 664, datë 26.9.2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 514, DATË 15.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR INFORMATIZIMIN E LLOGARITJES SË KOSTOS DHE HARTIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, të neneve 10 e 17 të ligjit nr. 8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", të ndryshuar, dhe të neneve 49 pika 1 e 57 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 të ndryshohet, si më poshtë vijon: "1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave, situacioneve dhe të analizave teknike të çmimeve me qëllim

lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në fushën e ndërtimit, si dhe lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar në këtë fushë.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Hartimi i çdo preventivi apo situacioni në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen në përputhje me këtë vendim.”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Metodologjia e llogaritjes së kostos, sipas këtij vendimi, është pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.”.

4. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “a”, “b” dhe “c” shfuqizohen.

b) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Subjekte deklaruese janë të gjitha subjektet private dhe/ose publike, që kryejnë veprimtari në fushën e prodhimit të materialeve të ndërtimit, të tregtimit të tyre ose në fushën e ndërtimit, sipas përkufizimit të bërë në kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.”.

c) Shkronja “d” shfuqizohet.

ç) Shkronja “dh” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit është buletini periodik vjetor dhe përmban çmimet e punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të punimeve të ndërtimit, të specifikuara sipas numrit të analizave.”.

d) Në fund të shkronjës “e” shtohen fjalët “... i cili botohet një herë në vit, në muajin maj ...”.

5. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Përditësimi i analizave teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit kryhet nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.”.

6. Pikat 6 dhe 7 shfuqizohen.

7. Në pikën 8, termi “SSK”, sektori i standardizimit të kostos, zëvendësohet me emërtimin “Drejtorinë e Politikave të Ndërtimit”.

8. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Vlera e zërave të punës të preventivave të objekteve që ndërtohen me financim publik të projektuara nga subjekte, publike apo private, llogariten si prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të projektit me çmimet për njësi të manualit teknik të çmimeve në fuqi.

Vlera e zërave të punës të situacioneve të ndërtimit del nga prodhimi i volumeve të punës, të llogaritura në librezën e masave të zbatimit me çmimet për njësi të llogaritura mbi bazën e analizave teknike të punimeve të ndërtimit, sipas vlerave faktike.”.

9. Në fund të pikës 12, fjalët “... të llogaritura me programin e miratuar ...” zëvendësohen me “... Në rastin kur zëri i punës nuk figuron në manual, institucioni u kërkon subjekteve ofertuese të paraqesin analizën teknike, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave dhe të paraqitur me formatin e unifikuar. Një fotokopje të analizave të paraqitura nga subjektet ofertuese për zërin e punës, institucioni ia dërgon ministrisë, e cila e shqyrton analizën e re dhe nëse e gjykon të drejtë, e reflekton çmimin në manualin e çmimeve të periudhës vijuese ...”.

10. Në fund të pikës 13 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për çdo objekt, në preventiv duhet të parashikohet një fond i veçantë, i cili shërben për zbatimin e masave për sigurinë në kantier, në zbatim të vendimit nr. 312, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI. Vlera e këtij fondi do të dalë në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet, por, në çdo rast, jo më pak se 3% e vlerës së tij.”.

11. Pikat 14, 15 dhe 16 shfuqizohen.

12. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore që në planifikimin e investimeve të bazohen në manualin teknik të çmimeve dhe analizave teknike të tyre të vitit aktual, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.”.



13. Pika 18 shfuqizohet.

14. Në pikën 19, fjala "... e Telekomunikacionit..." shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 667, datë 12.9.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
PUNËVE TË JASHTME, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË AKTIVITETEVE NË
KUADËR TË MARRJES SË PRESIDENCËS SHQIPTARE TË KOMITETIT TË MINISTRAVE
TË KËSHILLIT TË EUROPËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në programin 01120 "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", t'i shtohet fondi i përgjithshëm prej 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) eurosh, kundërvlehtë në lekë, për përballimin e shpenzimeve të aktivitetëve në kuadër të marrjes së presidencës shqiptare të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 669, datë 3.10.2012

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 520, DATË 1.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
"PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË FORMËS SË ORGANIZIMIT DHE TË STATUTIT TË
QENDRËS "ECAT TIRANA" DHE PËR KONTRIBUTIN E QEVERISË SHQIPTARE PËR
KËTË QENDËR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 520, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e ndryshimit të formës së organizimit dhe të statutit të qendrës "ECAT Tirana" dhe për kontributin e qeverisë shqiptare për këtë qendër".

2. Funksionimi i qendrës “ECAT Tirana” t’i nënshtrohet ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 670, datë 3.10.2012

PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT NË ROMË, ITALI, TË DISA OBJEKTEVE TË RRALLA ME VLERA UNIKE, NË KUADËR TË REALIZIMIT TË EKSPOZITËS “THESARE TË KULTURËS SHQIPTARE”, NGA DATA 20 NËNTOR 2012 DERI MË 6 JANAR 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 19 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e ekspozimit në Romë, Itali të disa objekteve të rralla me vlera unike, në kuadër të realizimit të ekspozitës “Thesare të kulturës shqiptare”, nga data 20 nëntor 2012 deri më 6 janar 2013, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ekspozimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të bëhet në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 18.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për lëvizjen e objekteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme, me vlera të veçanta kombëtare dhe unikale, për restaurimin, studimin dhe ekspozimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Instituti i Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” të kryejë shoqërimin dhe kthimin e ikonave në vendin e origjinës, pas mbarimit të veprimtarisë, dhe Qendra e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të kryejë regjistrimin e lëvizjes së objekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Lidhje 1

1. MUZEU HISTORIK KOMBËTAR

N r	Fi g	Emerti mi	Inventari	V. gjetja	Periudha	Materiali	Permasa cm	Vendndodhja e objektit	Vërejtje	Vitrina/Grupi
1	3	Idhull	MHK 987	Dunavec	Neoliti i Mesëm Mj 5-4	Qeramikë	H 8	TIRANË		V1 nr 2
2	8	Gjerdan	MHK 985	Blaz	Neoliti i Mesëm Mj 5-4	Gur	L 26.5	TIRANË		V1 nr 4
3	9	Enë antropo morfe	MHK 8135	Kamnik	Neoliti i Vonë Mj 4-3	Qeramikë	H 14	TIRANË		V1 nr 6
4	11	Enë	MHK 8137	Kamnik	Neoliti i Vonë Mj 4-3	Qeramikë	H 16	TIRANË		V1 nr 8
5	12	Objekt Kult	MHK 4677/A	Kamnik	Neoliti i Vonë Mj 4-3	Qeramikë	H 32	TIRANË		V1 nr 7
6			MHK	Pazhok				TIRANË	Duhet parë	
7	39	Spirale	MHK 1076, 1076/1	Bruç	Shek. 12 pK	Ar	L 6	TIRANË		V4 nr 2
8	54	Enë	MHK 1125	Barç	Shek 10-9	Qeramikë	H 14	TIRANË		V2 nr 11
9	61	Enë Dyshe	MHK 1122	Barç	Shek 10-9	Qeramikë	H 19	TIRANË		V2 nr 10
10	62	Enë Treshe	MHK 1123	Barç	Fillimi i 8 pK	Qeramikë	H 13	TIRANË		V2 nr 12
11	66	Varëse antropo morf	MHK 1136	Kuç i Zi	Shek 8-7	Bronz	L 9.2	TIRANË		V5 nr 1
12	67	Varëse	MHK	Kuç i Zi	Shek 8-7	Bronz	H 5.5	TIRANË		V5 C2

		në formë zogu	1109				B 4.6			
13	94	Skifos	MHK 1121	Çinamak	Fundi i 6 - Fillimi i 5	Qeramikë	H 18	TIRANË		V2 nr 17
14	107	Aribal	MHK 1184	Apollonia	Gjysma e parë shek 6 pK	Bronz	L 17.7	TIRANË		V6 nr 4
15	110	Nike	MHK 1225	Butrint	Gjysma e dytë shek 5 pK	Mermer	H 81	TIRANË		V8 b
16	112	Statujë/këmbë	MHK 1304, 1305	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Bronz	H 44	TIRANË		V7 nr 6
17	113	Krater me voluta	MHK 1256	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Qeramikë	H 60	TIRANË		V8, d
18	140	Monedhë e Labeatëve	MHK 1189	Çinamak	168-147	Bronz	D 2	TIRANË		V 13, 4
19	181	Kokë mashkulli	MHK 1262	Apolloni	Gjysma e parë shek 3 mK	Mermer	H 28	TIRANË		V12, b
20	186	Pjatë	MHK 1278	Lisus	Gjysma e dytë shek 3 pK	Qeramikë	D 20.2	TIRANË		V11 nr 2
21	187	Enë kozmetike	MHK 1264	Durrës	Gjysma e dytë shek 4 pK	Qeramikë	H 27	TIRANË		V8 nr 7
22	212	Amforë	MHK 1171	Apolloni	Fundi i shek 5 pK	Qeramikë	H 52.5	TIRANË		V8 e, nr 1
23	213	Krater	MHK 1274	Apolloni	Fundi i shek 5 pK	Qeramikë	H 58	TIRANË		V8 e, nr 2
24	21	Statujë	MHK	Amantia	470 pK	Bronz	H 10	TIRANË		V10 nr 1

	6	atleti	1244							
25	23 9	Statujë e një dashi	MHK 1159	Amantia	Shek 3 pK	Bronz	L 7	TIRANË		V10 nr 7b
26	24 3	Statujë maceje	MHK 1158	Amantia	Shek 3 pK	Bronz	H 9	TIRANË		V10 nr 8
27	24 7	Stelë e farkëtar ëve	MHK 1325	Tren	Shek 4 mK	Gur gëlqeror	H 31.5	TIRANË		V16 a
28	25 6	Kandil, Medusa	MHK 1350	Apolloni	Shek 1 mK	Bronz	H 5.5	TIRANË		V15 b, nr 2
29	25 8	Kapëse në formë sfinksi	MHK 1238	Antigone	Gjysma e dytë shek 3 pK	Bronz	H 13	TIRANË		V9 nr 9
30	28 4	Gjuhëz ripi	MHK 1283	Selca e poshtme	Gjysma e dytë shek 3 pK	Argjend, hekur	H 5	TIRANË		V9 nr 11
31	28 9	Vathë	MHK 1291	Selca e poshtme	Gjysma e dytë shek 3 pK	Ar me granat	H 4.5	TIRANË		V9 nr 12 d
32	29 0	Gjerdan	MHK 1288	Selca e poshtme	Gjysma e dytë shek 3 pK	Ar	L 16	TIRANË		V9 nr 12 c
33	29 1, 29 2	Vathë	MHK 1286/87, 1289/90	Selca e poshtme	Gjysma e dytë shek 3 pK	Ar dhe granat	D 2.5	TIRANË		V9 nr 12 a-b
34	30 1	Kokë femre	MHK 1363	Qesarat	Shek 1-2	Mermer	H 24	TIRANË		V14 f
35	30 6	Statujë - kokë	MHK 1234	Durrës	Shek 3 pK	Terrakotë	H 16	TIRANË		V11 nr 5
36	31 2	Koka e Artemis ës	MHK 1259	Apolloni	Shek 3 pK	Mermer	H 30	TIRANË		V12 f

37	31 3	Koka e Apollon it	MHK 1227	Butrint	Gjysma e parë shek 4 pK	Mermer	H 50	TIRANË		V14 0
38	31 5	Statujë e Poseido nit	MHK 1239	Antigone	Gjysma e dytë shek 3 pK	Bronz	H 14.5	TIRANË		V10 nr 11
39	31 8	Dorë votive	MHK 1345	Vau i Dejës	Shek 3 pK	Bronz	H 11	TIRANË		V10 nr 12
40	32 6	Stelë	MHK 1226	Cakran	Shek 3 pK	Gur gëlqeror	H 61	TIRANË		V12 i
41	34 8	Kokë njeriu	MHK 1372	Durrës	Shek 4 mK	Gur gëlqeror	H 26	TIRANË		V16 b
42	36 0	Shtyllë me reliev	MHK 1377	Ballsh	Shek 6 mK	Gur gëlqeror	H 134	TIRANË		V16 e
43	36 4	Fibul disk	MHK 1449	Krujë	Shek 7-8	Bronz	D 8.9	TIRANË		V17 nr 3a
44	36 5	Fibul disk	MHK 1488	Krujë	Shek 7-8	Ar dhe argjend	D 6.8	TIRANË		V17 nr 3b
45	37 4	Zbukuri m	MHK 1746	Krujë	Shek 7-8	Bronz	L 8.7	TIRANË		V17 nr 7
46	37 6	Varg perlash	MHK 1483	Shurdhah	Shek 7-8	Xham	L 32	TIRANË		V17 nr4a
47		Reliev	MHK 1189	Amantia	Shek 3-2	Gur gëlqeror	H 19	TIRANË		V12, d
48		Stelë	MHK 1229	Apolloni	Shek 3 pK	Gur gëlqeror	H 200	TIRANË		V12, k



MUZEU ARKEOLOGJIK TIRANË

Nr	Fig sipas librit Genscher-Malile	Emertim	Inventari	V. gjetja	Periudha	Materiali	Perm as cm	Vendndodhja e objektit	Vitrina/grupi	Numri brenda vitrinës/grupit
1	1	Enë	MA 13026	Podgorie	Neoliti i Hershëm Mj 6	Qeramikë	H 23	TIRANË	V1	1
2	2	Enë Kult	MA 13207	Podgorie	Neoliti i Hershëm Mj 6	Qeramikë	H 5	TIRANË	V1	3
3	7	Enë Kult	MA 9596	Dunavec	Neoloti i Mesëm Mj 5-4	Qeramikë	L 22.5	TIRANË	V1	5
4	22	Sëpatë	MA, 8273	Kamnik	Eneolit 2600-2010	Bakër	L 14	TIRANË	V1	9
5	21	Stampa	MA 3224, 3551, 3682, 4575, 4576, 5482	Maliq	Eneolit 2600-2010	Qeramikë	Rreth 6	TIRANË	V1	10
6	23,a	Lugë kocke	4646	Maliq	Eneolit	Kockë	L 12.7	TIRANË	V1	11
7	26	Sëpatë	MA 1668	Rëmbec	Bronz i Hershëm, 2100-1800	Bakër	L 16	TIRANË	V2	1
8	27	Idhull	MA 90	Shtoj	Bronz i Hershëm, 2100-1800	Qeramikë	H 16	TIRANË	V2	2
9	28	Model Furre	MA 4778	Maliq	Bronz i Hershëm 2100-1800	Qeramikë	H 6.5	TIRANË	V2	3
10	25	Enë	MA 221	Shtoj	Bronz i	Qeramikë	H	TIRANË	V2	4

					Hershëm 2100-1800		14.5			
11	32	Tas	MA 2265	Pazhok	Bronz i Mesëm 1800-1500	Qeramikë	D 11.5	TIRANË	V2	5
12	60	Lekit	MA 7975	Bajkaj	Fundi i 11 p.Kr	Qeramikë	H25	TIRANË	V2	6
13	51	Enë	MA12518	Piskovë	Shek 11-10	Qeramikë	H 14.5	TIRANË	V2	7
14	52	Enë	MA 8470	Barç	Shek 11-10	Qeramikë	H 13.5	TIRANË	V2	8
15	48	Enë	MA 8473	Barç	Shek 10-9	Qeramikë	H 10.5	TIRANË	V2	9
16	97	Enë	MA 7010	Çinamak	Shek 6 p.Kr	Qeramikë	H 13	TIRANË	V2	13
17	98	Enë	MA 7758	Çinamak	Shek 6 p.Kr	Qeramikë	H 11.5	TIRANË	V2	14
18		Shpatë	MA 1207	Vajzë	1800-1500	Bronz	L 37.5	TIRANË	V3	1
19	29 b	Shpatë Mikene	MA 6	Komsi	Bronz i Vonë 1400-1100	Bronz	L 69	TIRANË	V3	2
20	44	Shpatë	MA 1506	Bajzë	Shek 11-10	Bronz	L 62	TIRANË	V3	3
21	45	Shpatë	MA 9398	Barç	Fundi i 12-Fillimi i 11	Bronz	L 41	TIRANË	V3	4
22	46	Shpatë	MA 10207	Dukat	Fundi i 12-Fillimi i 11	Bronz	L 35.5	TIRANË	V3	5
23	38	Sëpatë	MA 1238	Shelcan	Bronz i Vonë 1400-1100	Bronz	L 20	TIRANË	V3	6
24	41	Sëpatë dytehësh e	MA 1238	Polis	Shek 14-12	Bronz	L 21	TIRANË	V3	7
25	47	Maja Heshte	MA 8556, 2267	Vodhinë, Barç,	Shek 12-11	Bronz	L 12.5	TIRANË	V3	8

				Pazhok			20.3			
							25.6			
26	49	Thesar Sëpatash	MA 11856	Torovicë	Shek 10 pK	Bronz	L 10- 27	TIRANË	V3	9
27	57	Spirale	MA 10, 11	Barç	Shek 12-11	Ar	H 2.5	TIRANË	V4	3
28	55 a	Fibul	MA 8531	Barç	Shek 10 pK	Bronz	L 11.1	TIRANË	V4	4, a
29	55 b	Fibul	MA 18	Patos	Shek 10 pK	Bronz	L 2.7	TIRANË	V4	4, b
30	55 c	Gjilpërë	MA 11287	Barç	Shek 11-10	Bronz	L 24. 5	TIRANË	V4	4, c
31	55 d	Gjilpërë	MA 9383	Barç	Shek 10 pK	Bronz	L 43.2	TIRANË	V4	4, d
32	56	Diademë	MA 8507	Barç	Shek 10-9	Bronz	D 20	TIRANË	V4	5
33	75	Varëse	MA 7391	Kuç i Zi	Shek 7 pK	Bronz	L 5.9	TIRANË	V5	3
34	76	Varëse sferike	MA 7321	Kuç i Zi	Shek 7 pK	Bronz	L 4.2	TIRANË	V5	4
35	72	Vathë	MA 9	Kuç i Zi	Shek 6 pK	Ar	L 3.5	TIRANË	V5	7
36	90 b	Gjilpërë me kokë në formë syri	MA 6988	Çinamak	Shek 6-5	Argjend	L 7.3	TIRANË	V5	8
37	92	Fibul	MA 1278	Bajzë	Shek 6 pK	Bronz	L 4.4	TIRANË	V5	9
38	85	Fibul	MA 3026	Gajtan	Fundi i 6	Argjend	L 6.3	TIRANË	V5	10
39	90 a	Gjilpërë	MA 7076	Çinamak	Fundi i 6 pK	Argjend	L 11	TIRANË	V5	A
40	69	Vathë	MA 8338, 8338/1	Çinamak	Fundi i 6- Fillimi i 5	Argjend	L 4.5	TIRANË	V5	B
41	91	Gjerdan	MA 7680	Kuç i Zi	Shek 6-5	Xham, qelibar	L 40	TIRANË	V5	C1
42	86	Fibul me	MA 1274	Bajzë	Shek 6 pK	Bronz	L	TIRANË	V5	D

		varëse					11.8			
43	82	Fibul disk	MA 1287, 1287/1	Shtoj	Shek 6 pK	Bronz	D 7	TIRANË	V5	E
44	83	Brez	MA 45	Shtoj	Shek 6 pK	Bronz	H 7	TIRANË	V5	F
45	81	Varëse mesi	MA 1382	Bajzë	Shek 6 pK	Bronz	L 46	TIRANË	V5	G
46		Kokë femre	MA 4861	Durrës	580-570	Terrakotë	H 34	TIRANË	V6	1
47	158	Statujë luftëtari	MA 35	Përmet	Gjysma e dytë shek 5 pK	Bronz	H 16.5	TIRANË	V6	2
48	108	Statuje nike	MA 6290	Apolloni	Gjysma e parë shek 6 pK	Bronz	H 9.2; B 9.5	TIRANË	V6	7
49	104	Statujë Femre	MA 6979	Apolloni	Fundi i 6 pK	Terrakotë	H 11	TIRANË	V6	8
50	119	Oinohe	MA 11730	Belsh	Mesi i shek 6 pK	Bronz	H 25.5	TIRANË	V6 C	
51	217	Stelë varri	MA 85	Perhondi	Fundi i shek 5 pK	Mermer	H 99	TIRANË	V6 D	
52	96	Përkrena re	MA 8318	Çinamak	Shek 5 pK	Bronz	H 27	TIRANË	V7	3
53	157	Përkrena re	MA 2029	Dushk	Shek 4 pK	Bronz	H 23	TIRANË	V7	4
54	111	Përkrena re	MA 11717	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Bronz	H 20	TIRANË	V7	5
55	155	Përkrena re Korintike	MA 1477	Bastar	Gjysma e parë shek 5 pK	Bronz	H 25	TIRANË	V7	7
56	297	Krater	MA 4269	Apolloni	Gjysma e parë shek 4 pK	Qeramikë	H 41	TIRANË	V8 a	2



57	262	Oinohe	MA 250	Amantia	Gjysma e dytë shek 5 pK	Bronz	H 21	TIRANË	V8 c	1
58	184	Hidrie	MA 9221	Apolloni	Gjysma e dytë shek 5	Bronz	H 59	TIRANË	V8 c	2
59	95	Kantar	MA 1757	Perlat	425-400	Qeramikë	H 21.5	TIRANË	V8	1
60	117	Sitë	MA 11729	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Bronz	L 22.2	TIRANË	V8	2a
61	118	Kupë/Fil xhan	MA 11719	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Bronz	D 15.5	TIRANË	V8	2b
62	121 a, b	Kilikë	MA 11727, 11728	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Bronz	H 7	TIRANË	V8	3
63	122 a, b	Askoi	MA 11699, 11704	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Qeramikë	H 16	TIRANË	V8	4a
64	123 a, b	Skifos	MA 11686, 11687	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Qeramikë	H 7.5	TIRANË	V8	4b
65	125 a, b	Fibula palmetë	MA 11732, 11736	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Argjend	L 5.6, 6.2	TIRANË	V9	1-2
66	126 a, b	Vathë	MA 1755, 1755/1	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Argjend	H 6	TIRANË	V9	3
67	127 a, b	Gjilpërë me kokë disku	MA 11797, 11798	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Argjend	L 14.8, 15.2	TIRANË	V9	4
68	128 a, b	Byzylyk	MA 11753,	Belsh	Mesi i shek 4 pK	Argjend	D 8	TIRANË	V9	5

			11753/1							
69	194	Gjerdan	MA 78	Foinike	Shek 3 pK	Ar dhe Granat	L 34	TIRANË	V9	6
70	195	Gjerdan	MA 77	Foinike	Gjysma e dytë shek 3 pK	Ar	L 40	TIRANË	V9	7
71	227	Varëse	MA 3	Laç	Shek 1-2 mK	Ar	D 3	TIRANË	V9	8 a
72	228	Vathë	MA 14303	Durrës	Fundi i shek 3	Ar	L 18	TIRANË	V9	8 b
73	279	Fibul, vathë, unazë	MA 12611, 12611/1, 12615, 12619	Radhimë	Gjysma e dytë shek 4 pK	Argjend	L 8.8, d 3.5, d 2	TIRANË	V9	10 b
74	280	Byzylyk	MA 12612	Radhimë	Gjysma e dytë shek 4 pK	Argjend	H 6	TIRANË	V9	10 a
75	331	Stoli zbukurim i	MA 46, 46/1, 47, 48, 49, 50, 51	Belsh	Gjysma e dytë shek 3 pK	Ar	L 45	TIRANË	V9	13 a
76	209	Statujë atleti	MA 9178	Selca e Poshtme	480 pK	Bronz	H 6.5	TIRANË	V10	3
77	208	Statujë muzikant i	MA 2000	Bixëllenjë , Elbasan	Shek 3 pK	Bronz	H 12.5	TIRANË	V10	4
78	215	Statujë e Efebesit	MA 1079	Amantia	Shek 3 pK	Bronz	H 6.5	TIRANË	V10	5
79	207	Maskë teatri i Erosit	MA 8915	Selca e Poshtme	Shek 3 pK	Bronz	H 14.3	TIRANË	V10	6
80	300	Statujë	MA 13836	Butrint	Shek 3 pK	Bronz	H 17	TIRANË	V10	9
81	302	Kokë	MA 1028	Irmaj	Shek 3 pK	Bronz	H 4.7	TIRANË	V10	10

		satiri								
82	151	Piksas	MA 29	Armen, Vlorë	Gjysma e dytë shek 3 pK	Qeramikë	D 19	TIRANË	V11	1
83	309	Statujë	MA 13295	Margëlliç	Gjysma e dytë shek 3 pK	Terrakotë	H 44.5	TIRANË	V11	7
84	308	Statujë – kokë	MA 288	Durrës	Shek 3 pK	Terrakotë	H 9	TIRANË	V11	8
85	211	Altar	MA 324	Bylis	Shek 3 pK	Gur gëlqeror	H 95	TIRANË	V12	c
86	275	Statujë, herme i minës	MA 30	Gjyralë	Gjysma e dytë shek 3 pK	Gur gëlqeror	H 46	TIRANË	V12	e
87	129	Thesar monedha sh						TIRANË	V13	1
88	136 a-c	Monedha , Mbreti Monun	MA 7896, 7884/A, 7883/B	Kreshpan	Çereku i parë shek 3 pK	Argjend	D 2.1	TIRANË	V13	2
88	137	Monedhë , Mbreti Gent	MA 4773, 6368	Shkodër- Lezhë	181-168	Bronz	D 1.8, 1.7	TIRANË	V13	3
89	141	Monedhë Damastio n	MA 7821	Vendndod hje e panjohur	Shek 4 pK	Argjend	D 2.1	TIRANË	V13	5
90	142 a, b	Monedha nga Amantia	MA 6229, 2073	Amantie	260-168	Bronz	D 1.9-2	TIRANË	V13	6
91	143 a, b	Monedha nga Shkodra	MA 4383, 3804	Vendndod hje e panjohur	168-148	Bronz	D 1.7	TIRANË	V13	7
92	144 a, b	Monedha nga	MA 6965, 7845	Olimp	229-148	Bronz	D 1.8, 1.5	TIRANË	V13	8

		Olimpi								
93	145 a, b	Monedha nga Lisusi	MA 7730, 6395	Lisus	213-181	Bronz	D 1.5, D 1.4	TIRANË	V13	9
94	146 a, b	Monedha nga Bylis	MA 4845, 4782	Bylis	230-148	Bronz	D 1.4, 1.3	TIRANË	V13	10
95	147 a, b	Tesera nga Bylisi	MA 7928/1-2	Bylis	Gjysma e parë shek 2 pK	Bronz	D 2.3, 2.5	TIRANË	V13	11
96	148 a-d	Tesera nga Antigone a	MA 6333/1-4	Antigone	Gjysma e parë shek 2 pK	Bronz	D 2, 1.9	TIRANË	V13	12
97	182	Koka e një të riu	MA 579	Apolloni	Shek 1 mK	Mermer	H 33	TIRANË	V14	d
98	303	Statujë	MA 759	Qesarat	Shek 1-2	Mermer	H 80	TIRANË	V14	e
99	139	Kokë burri	MA 577	Lushnjë	Shek 2 pK	Mermer	H 30	TIRANË	V14	g
100	177	Hera	MA 725	Durrës	Kopje romake Shek 2 mK	Mermer	H 44	TIRANË	V14	i
101	175	Statujë mashkull i	MA 4864	Apolloni	Fundi i shek 2 mK	Mermer	H 184	TIRANË	V14	l
102		Stelë	MA 1500	Apolloni	Shek 2 mK	Gur Gëlqeror	H 77	TIRANË	V14	n
103		Statujë mashkull i	MA 3	Apolloni	Gjysma e parë shek 3 mK	Mermer	192	TIRANË	V14	o
104	15 nga Sh Gj	Enë	MA 16543	Librazhd	Shek 1 mK	Bronz	???		V15	a
105	Nr 1Sh Gj	Kapak							V15 b	1
106	305	Statujë e	MA 731	Durrës	Shek 2 mK	Bronz	H 18	TIRANË	V15 b	3



		erosit me delfin								
107	319	Tabelë votive	MA 20	Shalë	Shek 2-3	Bronz	H 36	TIRANË	V15 b	4
108	Sh Gj list		MA16545		Shek 1-2	Bronz			V15 b	6
109	350	Stelë	MA 5600	Drashovic ë	Shek 4 mK	Gur gëlqeror	H 58.5	TIRANË	V16	c
110	SH GJ	Kandil						TIRANË	V17	1
111	375	Vathë	MA 28	Shishtufin ë	Shek 7 mK	Ar	H 4.5	TIRANË	V17	2
112	377	Dy vargje perlash	MA 45, 45/1	Krujë	Shek 7-8	Xham	L 27, 25	TIRANË	V17	4b
113	370	Vathë	MA 4843, 4843/1	Krujë	Shek 7-8	Ar	H 5.2	TIRANË	V17	5a
114	371	Vathë	MA 12176, 12176/1	Krujë	Shek 7-8	Argjend	D 6	TIRANË	V17	5b
115	373	Dy fibula	MA 106, 501	Koman	Shek 7-8	Bronz	L 5.3	TIRANË	V17	5c
116	378	Varëse	MA 540	Koman	Shek 7-8	Bronz	D 21	TIRANË	V17	6
117	372	Vathë, 1 palë	MA 10443	Rehovë	Shek 9 mK	Argjend	L 10	TIRANË	V17	8
118	Sh Gj	llampë						TIRANË	V17	10

MUZEU ARKEOLOGJIK Apolloni

N r	Fig	Emerti mi	Inventari	V. gjetja	Periudha	Materiali	Permas cm	Vendndodhja e objektit	Vërejtje	Vitrina/ grupi
1	101	Figurë në relief	MA 923	Apolloni	Fillimi i 6 pK	Plumb	H 8.5	APOLLONI		V6 nr 5
2	102	Olpe	MA 23	Apolloni	Nga 600 pK	Qeramikë	H 46.5	APOLLONI		V6 a
3	103	Olpe	MA 87	Apolloni	Fillimi i 6 pK	Qeramikë	H 24	APOLLONI		V6 nr 6
4	105	Statujë Shtizëhe dhësi	MA 3464	Apolloni	Mesi i Shek 6 pK	Bronz	H 22	APOLLONI		V6 nr 8
5	169	Oinohe	MA 148	Apolloni	Fillimi i shek 4 pK	Qeramikë	H 24.5	APOLLONI		V8 nr 5
6	221	Statujë femre	MA 1072	Apolloni	Shek 3 pK	Terrakotë	H 33	APOLLONI		V11 nr 3
7	261	Amfora	MA 865	Apolloni	Gjysma e dytë shek 6 pK	Bronz	H 40	APOLLONI		V6 B
8	293	Statujë e Zeusit	MA 5400	Apolloni	460 pK	Bronz	H 25.5	APOLLONI		V10 nr 2
9	314	Reliev me Atlasin	MA 143	Apolloni	Shek 2 mK	Gur gëlqeror	H 74.5	APOLLONI		V14 m
10	324	Stelë	MA 5030	Apolloni	Shek 3 pK	Gur gëlqeror	H 195	APOLLONI		V12 h
11	328	Stelë me artemisën	MA 5031	Apolloni	Shek 3 pK	Gur gëlqeror	H 91.5	APOLLONI		V12 j
12	335	Bust i Vilias	MA 4756	Apolloni	130 mK	Mermer	H 59	APOLLONI		V14 k
13	347	Kokë atleti	MA 4770	Apollonia	Shek 2 mK	Mermer	H 2.2	APOLLONI		V14 h
14	Sh Gj	Mburojë	MA	Apollonia	Shek 6 pK	Bronz		APOLLONI		V7 1
15	217	Stelë	MA85	Fier	Shek 3	Bronz	H 38, B	APOLLONI		V12 a

		varri, tabele votive				24				
16		Krater	MA 325	Apolloni	Shek 4 pK	Qeramikë	H 35	APOLLONI		V8a, 1

LISTA E IKONAVE DHE DYER TE BUKURA**MUZEU I ARTIT MESJETAR KORCE**

NR	NR.INV	EMERTIMI	PERIUDHA	PREJARDHJA	VENDNDODHJA	PERMASAT	AUTORI
1	Ko 2228	Shen Meria Hodigitria	Shek. XV	Kisha Lindja e Shen Merise Maligrad, Korce	Muzeu Artit Korce	90,4x68x5cm	anonim
2	Ko 2242	Shen Nikolla	Shek XIV	Kisha Shen Gjergjit, Vithkuq, Korce	Muzeu Artit Korce	47x34x 4 cm	anonim
3 a	Ko 2281	Porta e altarit (fleta e majte)	Shek. XV	Shpella kishe Blashtonje, Prespe	Muzeu Artit Korce	118.2x39.4x4cm	anonim
3 b	Ko 2282)	Porta e altarit me Ungjillizim (fleta e djathte)	Shek. XV	Shpella kishe Blashtonje, Prespe e madhe	Muzeu Artit Korce	118.5x32x3cm	anonim
4 a	Ko 3683	Fragment Ungjilliz (fleta e majte)	Shek. XVI (mesi)	Kisha e Ungjillizimit, Berat	Muzeu Artit Korce	132x43x5.5 cm	Onufri
4 b	Ko 2684	Fragment Ungjillizi (fleta e djathte)	Shek. XVI (mesi)	Kisha e Ungjillizimit, Berat	Muzeu Artit Korce	132x41.5x4.5cm	Onufri
5	Ko 3673	Lindja e Krishtit	Shek. XVI (mesi)	Kisha e Ungjillizimit, Berat	Muzeu Artit Korce	54x34.5x3.8cm	Onufri
6	Ko 3679	Ngjallja e Krishtit	Shek. XVI (mesi)	Kisha e Ungjillizimit, Berat	Muzeu Artit Korce	54.5x36x3cm	Onufri
7	Ko 3675	Pagezimi i Krishtit	Shek. XVI	Kisha Ungjillizim. Berat	Muzeu Artit Korce	54.8x34.7x3.5cm	Onufri
8	Ko 2688	Shen Meria perkedhelese	Shek XVI	Katedralja Burimi jetdhenes, Korce	Muzeu Artit Korce	83x58	Anonim
9 a	Ko 5672	Kanati I djathte I deres se altarit	Shek. XVIII	Fshati Boboshtice, Korce	Muzeu Artit Korce	122x39.5x6.5cm	anonim
9 b	Ko 5671	Kanati I majte I deres se altarit	Shek. XVIII	Fshati Boboshtice, Korce	Muzeu Artit Korce	120x37x3.3cm	anonim
10	Ko 2278	Kryeengjelli Mihail	Shek. XIV	Korce	Muzeu Artit Korce	177.5x76.5x4.5cm	anonim

11	Ko 3629	Shen Joan Prodhromi	1599	Kisha e Konstandinit dhe Elenes	Muzeu Artit Korce	93x50x3.6cm	Onufer Qiprioti
12	Ko 2764)	Kryeengjelli Mehil	Shek. XIV	Kisha e shen Merise se Ristozit, Mborje	Muzeu Artit Korce	109x83.5cm	Anonim
13	6328	Kapak Ungjilli	Shek. XVIII	Korce, Voskopoje	Muzeu Artit Korce	59x38,5	Athanas

BERAT

14	Br 8468 (254/m)	Shen meria me krishtin ne krah te djathte	SHEK. XVI	Katedralja Fjetja e shen Merise, Kala Berat	Muzeu kombetar Onufri, Berat	129.5x76cm	Onufri
15	INV 18	Deisis i zgjeruar me shenjto	Shek. XVI	Kisha Ungjillizimi, Kala, Berat	Muzeu kombetar Onufri, Berat	98x87cm	Onufri
16	Inv 18	Hyrja ne Tempull	Shek. XVIII	Kisha e Ungjillizimit, Berat	Muzeu kombetar Onufri, Berat	54x34,5	Onufri
17	Br 8474	Burimi jetedhenes	Shek XVII	Shen Ilia, Perrua, Berat	Muzeu kombetar Onufri, Berat	55x36x5.3cm	anonim
18	Br 97	Lajmerimi	Shek. XIV	Katedralja Fjetja e Shen Merise, Kala Berat	Muzeu Onufri, Berat	37x32cm	anonim

TIRANA

19	1539	Epitafi Gllavinices	Shek XIV	Gllavinice	MHK Tirane	118x218cm	anonim
20	3681	Krishti ne fron	Shek XVIII	Kisha shen Nikolles Vanaj Fier	MHK Tirane	97x61	Kostandini



MUZEU Arkeologjik Butrint

Nr	Fig	Emertimi	Inventari	V. gjetja	Periudha	Materiali	Permas cm	Vendndodhja e objektit	Vërejtje	Vitrina/ grupi
1	Sh Gj, De Maria	Koka e Augustit	MA 501	Butrint	Shek. 1 pKr	Mermer		Butrint		V14 a
2	Sh Gj, De Maria	Koka e Livias	MA 502	Butrint	Shek 1. pKr	Mermer		Butrint		V14 b
3	Sh Gj, De Maria	Koka e Agripes	MA 503	Butrint	Shek 1. pKr	Mermer		Butrint		V14 b
4		Kryq bizantin	VPTSF172	Butrint	Shek 11 mKr	Bronz		Butrint		V17 nr 9

URDHËR

Nr. 4013, datë 29.10.2012

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, aktit normativ nr. 3, datë 1.8.2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”, të ligjit nr. 82/2012, datë 13.9.2012 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 1.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”, dekretit nr. 6201, datë 8.6.2009 të Presidentit të Republikës, me qëllim miradministrimin e burimeve njerëzore në Entin Kombëtar të Banesave dhe përmbushjen e përgjegjësisë sipas afateve ligjore,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave për trajtimin e korrespondencës/kërkesës së pronarëve të pasurive të paluajtshme, pasuritë e të cilëve dhe pas datës 1 nëntor 2012 janë ende të zëna, në kuptim të aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012 “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë të subjekteve të shpronësuar”, për trajtimin me konfirmim/njoftim, depozitimin e kërkesës në emër të kreditorit për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në gjykatë dhe mbajtje procesverbali për dorëzim urdhri ekzekutiv, drejtorëve të drejtorive rajonale të Entit Kombëtar të Banesave, si më poshtë vijon:

a) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012, në bashkitë Durrës, Shijak dhe Kavajë, drejtorit të drejtorisë rajonale Durrës. Drejtori i drejtorisë rajonale Durrës, në emër të EKB-së, t’i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv, në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme, si vijon:

i) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkive Durrës dhe Shijak në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës;

ii) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Kavajë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

b) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkinë Shkodër, drejtorit të drejtorisë rajonale Shkodër. Drejtori i drejtorisë rajonale Shkodër, në emër të EKB-së, t’i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme me vendndodhje (juridiksion) të rrethit Shkodër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

c) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë Korçë dhe rrethina, Ersekë, Bilisht, Pogradec, drejtorit të drejtorisë rajonale Korçë. Drejtori i drejtorisë rajonale Korçë, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme, si vijon:

i) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Korçë dhe rrethinave të saj, bashkive: Bilisht dhe Ersekë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;

ii) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Pogradec, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

ç) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkinë Vlorë, drejtorit të drejtorisë rajonale Vlorë. Drejtori i drejtorisë rajonale Vlorë, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Vlorë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

d) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë: Berat, Çorovodë, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan, drejtorit të drejtorisë rajonale Berat. Drejtori i drejtorisë rajonale Berat, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme me vendndodhje (juridiksion) në bashkitë: Berat, Çorovodë, Kuçovë, Ura Vajgurore, Poliçan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

e) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë: Elbasan, Peqin, Librazhd, drejtorit të drejtorisë rajonale Elbasan. Drejtori i drejtorisë rajonale Elbasan, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme me vendndodhje (juridiksion) në bashkitë: Elbasan, Peqin dhe Librazhd në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

ë) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë: Fier, Roskovec, Ballsh, drejtorit të drejtorisë rajonale Fier. Drejtori i drejtorisë rajonale Fier, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme pasuri me vendndodhje (juridiksion) në bashkitë: Fier, Roskovec, Ballsh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

f) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë: Gjirokastrë, Libohovë, Këlcyrë, Përmet, Sarandë dhe Delvinë, drejtorit të drejtorisë rajonale Gjirokastrë. Drejtori i drejtorisë rajonale Gjirokastrë, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme, si vijon:

i) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkive Gjirokastrë, Libohovë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;

ii) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkive Përmet dhe Këlcyrë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor në Përmet;

iii) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkive Sarandë dhe Delvinë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

g) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna edhe pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë Peshkopi dhe Burrel, kryetarit të degës rajonale Dibër. Kryetari i degës rajonale Dibër, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme, si vijon:

i) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Peshkopi, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;



ii) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Burrel, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

gj) Për pasuritë e paluajtshme pronë private, të zëna pas datës 1 nëntor 2012 në bashkitë Rrëshen dhe Krujë, kryetarit të degës rajonale Lezhë. Kryetari i degës rajonale Lezhë, në emër të EKB-së, t'i drejtojë kërkesat për lëshimin e urdhrit ekzekutiv në kuptim të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, të njoftimit respektiv për pasuritë e paluajtshme, si vijon:

i) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Rrëshen, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;

ii) Pasuri me vendndodhje (juridiksion) të bashkisë Krujë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Çdo pasuri e paluajtshme pronë private, e zënë edhe pas datës 1 nëntor 2012, objekti, i aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 3, datë 1.8.2012, me vendndodhje brenda bashkisë Tiranë ose në çdo bashki tjetër të përmendur në shkronjat "a" deri "gj" të pikës 1 të këtij urdhri, kompetent për trajtimin e kërkesës së pronarit, lëshimin e njoftimit, kërkesën për titull dhe procesverbalit respektiv është drejtori i përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave me qendër në Tiranë dhe në mungesë të tij, përgjegjës është zëvendës drejtori i përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave.

3. Për ushtrimin e kësaj përgjegjësie sipas pikës 1 dhe 2 të këtij urdhri, drejtori i përgjithshëm i EKB-së dhe drejtorët e zyrave rajonale, dhe kryetarët e degëve rajonale të përmendur në shkronjat "a" deri "gj" të pikës 1 të këtij urdhri, përdorin për trajtimin e kërkesës, njoftimin/konfirmimin, kërkesën në gjykatë dhe procesverbalin, aktet tip të miratuara nga Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

4. Kërkesat depozitohen nga pronarët nëpërmjet Postës Shqiptare, nëpërmjet shërbimit postar rekomandë me lajmërim marrjeje. Kjo formë dorëzimi përdoret për të dëshmuar afatet kur fillon detyrimi i EKB-së për lëshimin e njoftimit/konfirmimit dhe dërgimin e aktit në gjykatë. Ftohen pronarët e banesave të zëna të ndjekin këtë formë dorëzimi si i vetmi instrument ligjor që i garanton këtyre subjekteve transparencë dhe në çdo rast ankimi pranë ministrit dëshmon si provë e pakundërshtueshme aplikimin e subjektit. Përfaqësimi në gjykatën e rrethit gjyqësor në juridiksionin territorial respektiv, sipas Kodit të Procedurës Civile, do të kryhet nga stafi i EKB-së, me autorizim të lëshuar.

5. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të zyrës/kryetarit të degës rajonale respektive sipas pikës 1 të këtij urdhri, përgjegjës deri në caktimin e përfaqësuesit që e zëvendëson për ushtrimin e kompetencës me delegim, do të jetë punonjësi i zyrës apo degës rajonale që kryen detyrën e financierit të zyrës. Ky përfaqësim kryhet menjëherë dhe është në përputhje me këtë urdhër.

6. Drejtorët, në çdo rast për këtë përfaqësim sipas pikës 1 të këtij urdhri, i raportojnë me shkrim drejtorit të përgjithshëm të EKB-së për ecurinë e procesit çdo 3 ditë pune, gjatë gjithë muajit nëntor 2012 dhe 10-ditëshit (dhjetëditëshit) të parë të muajit dhjetor 2012 dhe për periudhën në vijim, një herë në javë. Raportin ia përcjellin për dijeni dhe ministrit. Raporti përmban numër aplikimesh të reja në javë nga pronarët, numër njoftimesh të hartuara, kërkesa të dërguara në gjykatë dhe numër procesverbalesh të mbajtura pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit. Këto të dhëna bëhen publike dhe në faqen zyrtare të EKB-së.

7. Drejtori i përgjithshëm i EKB-së do të shpërndajë staf të zyrave rajonale dhe zyrës qendrore, të papërfshira në proces për asistencë teknike të zyrave të mësipërme sipas varësisë së punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 1.11.2012
Doli nga shtypi më 1.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 54 lekë